



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primjeno/Prodato Received/Delivered	08.09.23	3	viti god year
Organ/Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
	6031/2023		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1015/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka rishqyrtuar ankesën A.nr.1015/2023 të datës 20.07.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike „kompensim material“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1. 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur, me datë 08.09.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Detyrohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit, duke nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesave të ankueses më Nr.851 të datës 03.03.2023, Nr.1427 të datës 06.04.2023, Nr.08.05.2023 si dhe Nr.2215 të datës 08.06.2023, të parashtruara nga ankuesja për kompensim të punës jashtë orarit të rregullt zyrtar.
- II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile me datë 20.07.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjen A.nr.1015/2023, ndaj Divizionit të Personelit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për shkak të mos realizimit të kompensimit të punës së realizuar pas orarit të rregullt zyrtar me ditë të pushimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 21.07.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa, kjo e fundit, me datë 26.07.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 5312/2023 të datës 20.07.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën përmes e-mailit zyrtar të datës 29.05.2023 nga Sekretari i Përgjithshëm në MBPZHR për Udhëheqësen e Personelit në këtë institucion; Kërkesën përmes e-mailit zyrtar të datës 26.05.2023 nga Udhëheqësja e Personelit për Sekretarin e Përgjithshëm të këtij institucioni; Komunikimet elektronike përmes e-mailave zyrtar të datës 15.06.2023, 20.06.2023 ndërmjet Udhëheqëses së Personelit dhe Sekretarit të Përgjithshëm në këtë institucion lidhur me punën jashtë orarit të ankueses; Kërkesën e ankueses me Nr.851 të datës 03.03.2023 për kompensimin e punës jashtë orarit të punës; Komunikimet elektronike përmes e-maileve zyrtare të datës 28.02.2023, 12.02.2023, 10.02.2023 ndërmjet ankueses dhe lidhur me çështjen në fjalë; Kërkesën e ankueses me Nr.2215 të datës 08.06.2023 për kompensimin e punës jashtë orarit dhe gjatë fundjavës; Komunikimet elektronike përmes e-maileve zyrtare të datës 05.05.2023, 06.05.2023, 07.05.2023, 14.05.2023, 12.05.2023, 17.05.2023 ndërmjet ankueses dhe lidhur me çështjen në fjalë; Kërkesën e ankueses me Nr.1427 të datës 06.04.2023 për kompensimin e punës jashtë orarit të punës; Komunikimin e datës 16.03.2023 përmes viberit ndërmjet ankueses dhe Komunikimet elektronike të datës 16.03.2023, 17.03.2023, 18.03.2023, 20.03.2023, 21.03.2023, 23.03.2023, 24.03.2023, 26.03.2023 ndërmjet ankueses dhe personave gjegjës të institucionit në fjalë lidhur me aktivitetet e zhvilluara e që lidhen me kompensimin e pretenduar nga ankuesja; Kërkesën e ankueses me Nr.1878 të datës 08.05.2023 për kompensimin e punës jashtë orarit të punës; Komunikimet elektronike përmes e-maileve zyrtare të datës 02.04.2023, 12.04.2023, 16.04.2023, 17.04.2023, 28.04.2023, 29.04.2023, 19.05.2023, 21.05.2023, 26.05.2023 ndërmjet ankueses dhe personave gjegjës të institucionit në fjalë lidhur me aktivitetet e zhvilluara e që lidhen me kompensimin e pretenduar nga ankuesja si dhe komunikimin elektronik përmes viberit të datës 02.04.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 21.07.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 26.07.2023 nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit e ankueses me Nr.3588 të datës 06.12.2012 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Gjendjen aktuale të hyrje daljeve të ankueses për periudhën nga data 01.02.2023-31.05.2023; Listën e pagave për ankuesen të muajit shkurt, mars, prill dhe maj të vitit 2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi, atëherë, ekziston baza ligjore që të detyrohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që të bëjë shqyrtimin e kërkesave të ankueses më Nr.851 të datës 03.03.2023, Nr.1427 të datës 06.04.2023, Nr.08.05.2023 si dhe

Nr.2215 të datës 08.06.2023, të parashtruar nga ankuesja dhe të nxjerr akt administrativ, *sepse:*

Nga analizimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe se e njëjta sipas Aktit të emërimit me Nr.3588, të datës 06.12.201, është emëruar dhe ushtron pozitën e punës *Shefe e Divizionit për Komunikim me Publikun*, në Departamentin për Shërbime Administrative.

Tutje, sipas provave të lëndës del se ankuesja përmes kërkesave për kompensimin e punës jashtë orarit dhe fundjavës dhe atë sipas kërkesës me Nr.851 të datës 03.03.2023, Nr.1427 të datës 06.04.2023, Nr.08.05.2023 si dhe Nr.2215 të datës 08.06.2023, i është drejtuar Udhëheqëses së Personelit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural lidhur me tre (3) ditët e punës gjatë muajit Shkurt, tetë (8) ditët e punës dhe ditëve të vikendit gjatë muajit Mars, për shtatë (7) ditët e punës dhe ditëve të vikendit gjatë muajit Prill si dhe nëntë (9) ditët e punës dhe ditëve të vikendit gjatë muajit Maj, të gjitha këto për kompensim me ditë të pushimit.

Ndërsa, Njësia e Personelit përmes përgjigjes së datës 15.06.2023 ka njoftuar ankuesen së kërkesat e saj për kompensim të punës jashtë orarit, nuk mund të realizohen, pa ndonjë aprovim nga udhëheqësi i drejtpërdrejt.

Kolegji i Këshillit lidhur me këtë çështje, në shqyrtim të pretendimeve ankimore ju referua Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, respektivisht nenit 36 me të cilën është përcaktuar se: *Zyrtaret/ët publik/e dhe kategoritë e tjera të të punësuarave/ëve që paguhen nga buxheti i shtetit, përjashtimisht funksionareve/ëve publik/e përfitojnë kompensim në vlerë monetare apo me pushim për punën me kujdestari, punën gjatë natës dhe jashtë orarit të punës, punën në fundjavë, punën në ditët e festave zyrtare. 2. Kompensimi sipas paragrafit 1. të këtij neni paguhet në përqindje të pagës bazë sipas ligjit përkatës për punë, si më poshtë: 2.1. 20 % në orë për kujdestari; 2.2. 30 % në orë për punë gjatë natës; 2.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit; 2.4. 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe 2.5. 50 % në orë për punë gjatë fundjavës... 5. Zyrtaret/ët publik dhe të punësuarat/it e tjera/ë që paguhen nga buxheti i shtetit, sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të kërkojnë nga punëdhënësjat që në vend të kompensimit në pagë nga paragrafi 2. i këtij neni, kompensimi t'i bëhet me ditë pushimi".*

Po ashtu, Kolegji mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 07/2023 për kompensimin për kujdestari, punën gjatë natës dhe punën jashtë orarit të punës, përkatësisht nenin 7, më të cilin parashihet se: *Kompensimi për punën jashtë orarit, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës 1. Zyrtarët publik dhe kategoritë e tjera të të punësuarave që paguhen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, kanë të drejtë të kompensohen për punën jashtë orarit të rregullt të punës, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës. 2. Puna jashtë orarit, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës mund të realizohet vetëm kur i punësuarit ka pëlqim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe ka autorizim paraprak të arsyetuar nga udhëheqësi më i lartë i institucionit. 3. Kompensimi për punën jashtë orarit të rregullt të punës, punën gjatë festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës bëhet me pagesë ose me ditë pushimi. 4. Kompensimi për punën jashtë orarit të rregullt të punës, punën gjatë festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës, llogaritet për çdo orë pune, duke i shtuar edhe vlerën si vijon: 4.1. Tridhjetë për qind (30%) në orë për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës;..... si dhe nenin 8 paragrafi 2 i kësaj rregullore ka përcaktuar se: 2. Kërkesa për kompensim për punë jashtë orarit të rregullt të punës, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës aprovohet nga zyrtari më i*

lartë administrativ i institucionit më së largu dhjetë (10) ditë pas përfundimit të orëve shtesë, duke plotësuar Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje..”

Andaj, meqenëse ankuesja kërkesat për kompensim të punës jashtë orarit në ditë të pushimit, i ka parashtruar vetëm të Njësia e Burimeve Njerëzore, e jo të Zyrtari më i lartë administrativ i institucionit në këtë rast Sekretari i Përgjithshëm, atëherë, Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh dispozitat ligjore si me lart, e në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 97 paragrafi 1, i cili përcakton se: *“1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative”,* konstaton se, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në cilësi të Zyrtarit Kryesor Administrativ të Institucionit, është i obliguar që duke marr për bazë të gjitha dispozita ligjore si me sipër, të shqyrtoj kërkesat e ankueses për kompensim të punës jashtë orarit dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Nisur nga konstatimet si me lart, Kolegji i këshillit, duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1015/2023

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Deçi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshme të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Udhëheqëses së Njësia së Burimeve të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Arkivit të KPMSHCK-së.